



E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 25.10.2022, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Elmira Nikçi - Rexha, Arton Brahim, Nenad Miladinovic, Faton Marolli, Trieria Kasumi - Berisha, Adnan Ajeti, Kimeta Shok, Oktay Kurtesh.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Betim Abdullahu, u.d udhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Fisnik Dida, përfaqësues nga OSBE-ja dhe përfaqësuesit nga KFOR-i.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Mirsada Behluli kryesuese e komitetit me këtë

R E N D T Ë D I T Ë S:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit nga mbledhja e kaluar;
2. Ftesë për kryesuesin e Kuvendit të Komunës z. Fehmi Kupina;
3. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, znj. Besianë Musmurati;
4. Raport nga vizita në shkollë ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë;
5. Raporti i ZKKE-së, për muajin gusht 2022;
6. Dorëzimi i listave të familjeve të cilat kanë nevojë për dru zjarri;
7. Raportimi nga përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë për gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;
8. Të ndryshme.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Ftesë për kryesuesin e Kuvendit të Komunës z. Fehmi Kupina

Me arsyetimin e mospjesëmarrjes së kryesuesit të Kuvendit të Komunës z. Fehmi Kupina, mbetet të ftohet në njërin prej takimeve të ardhshme të komitetit.

Pika e tretë

Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, znj. Besianë Musmurati

Kryesuesja tha se kjo pikë e rendit të ditës, mbetet për mbledhjen e radhës.

Pika e katërt

Raport nga vizita në shkollë ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë

Mirsada Behluli, kryesuese tha se lidhur me raportin nga vizita në shkollë ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë gjatë muajit tetor, së bashku me komisionin kanë vizituar të gjitha shkollat ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë.

Ajo në vazhdim tha se gjatë vizitës në shkollën fillore "Naim Frashëri" dhe atë të mesmen "Ali Sokoli", ku vijojnë mësimin nxënësit e komunitetit boshnjak jemi informuar se në shkollën fillore "Naim Frashëri", ka paralele në gjuhën boshnjake prej klasës së parë deri në klasën e nëntë, prej klasës së parë deri në të pestën janë tetë nxënës, ku prej tyre janë gjashtë meshkuj e dy vajza.

Prej klasës së pestë deri në klasën e nëntë janë katër nxënës, pra në përgjithësi janë dymbëdhjetë nxënës, ku prej tyre dhjetë janë të komunitetit boshnjak dhe dy janë nga komuniteti rom.

Ajo mes tjerash tha se gjatë vizitës në shkollën fillore "Naim Frashëri", kanë marrë një raport të nënshkruar nga tri mësueset e komunitetit boshnjak e ato janë Bisera Bajrami, Ulfeta Rexhepagiq dhe Sadeta Kasumi, lidhur me problemet dhe shqetësimet që kanë të bëjnë me zhvillimin e punës e ato janë: Ka më se katër vjet mësimdhënësit e komunitetit boshnjak japin mësim me kurikulën e re pa libra në gjuhën boshnjake, pastaj materialin të cilin duhet ta posedojnë dhe plotësojnë nuk janë të përkthyer në gjuhën boshnjake, po ashtu edhe ditari digjital (E-shkollori) është në gjuhën shqipe ku na paraqet vështirësi në punë dhe evidentimin e të dhënave dhe notave.

Pastaj nuk ka kontrolle për punën e arsimtarëve (nuk ka inspektorë), mungesa e mësimdhënësve të komunitetit boshnjak, ku mësimdhënësja për gjuhën boshnjake nuk është me përgatitje adekuate, por është me pedagogji, pastaj arsimtari i gjuhës angleze është shqiptar e do duhej të ishte i komunitetit boshnjak.

Nenad Miladinović tha se kisha me propozuar që mundësisht të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës kur të jetë prezentë edhe drejtorja e arsimit e pastaj mund të diskutojmë.

Pika e pestë

Raporti i ZKKK-së, për muajin gusht 2022

Betim Abdullahu tha se sa i përket Raportit të ZKKK-së, për muajin gusht, nuk isha ndalur shumë tek raporti mujor se besoj se të gjithë e keni marrë dhe e keni lexuar, puna e jonë e zyrës ka vazhduar si çdo herë, por do të kaloja në pikën tjetër që ka të bëjë me listat e familjeve për dru zjarri.

Pika e gjashtë

Dorëzimi i listave të familjeve të cilat kanë nevojë për dru zjarri

Faqe2nga6

Lidhur me listën e familjeve me nevojë për dru zjarri, **Betim Abdullahu** tha se çdo vit i kemi subvencionuar familjet e komuniteteve me nevojë.

Vitin e kaluar janë përkrahur afër 160 familje, kurse këtë vit listën që e kemi marr prej përfaqësuesve të komuniteteve është 179 persona apo familje.

Projekti është mbështetur gjithmonë nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale edhe pse jemi marrur vesh që projekti ka me vazhduar me u subvencionuar njëjtë si herëve të tjera.

Ne i kemi dërguar njoftimet tek secili anëtarë i komitetit për me i sjell listat me persona që janë me nevojë, por para 2-3 ditëve Drejtoria e Mirëqenies Sociale na ka njoftuar që për shkak të buxhetit lista duhet të shkurtohet, ku shkurtimi është jashtëzakonisht i madh edhe na sjellë probleme shumë të mëdha.

Në bazë të emailit që ma kanë dërguar drejtorja dhe udhëheqësja e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, më kanë njoftuar se kanë mundësi ti përkrahin vetëm 30 persona, kështu që është hera e parë që na ka ndodhur prej shumë viteve, por të gjithë e dimë se ne si zyre nuk kemi buxhet të dedikuar jo vetëm për këto raste por edhe për raste të tjera dhe projekte të tjera që ne i kemi realizuar gjithmonë i kemi pasur me përkrahje nga drejtoritë përkatëse, e që tani neve na mbetet me e dërguar listën komplet në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale.

Unë si përfaqësues i zyrës nuk mundem me i ndarë apo me i klasifikuar se kush ka nevojë më shumë e kush jo.

Të gjithë këta që janë në listë unë e di që kanë nevojë edhe realisht barra bie në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale.

Unë do të kontaktoi me pjesën e organizatave ndërkombëtare që merren me pjesën e integritit dhe me komunitete në Kosovës, që mundësisht me i siguruar një pjesë të druve për zjarr.

Ai në vazhdim tha se kisha propozuar që ta miratoni sot këtë listë komplet ashtu që ne këtë listë me e dorëzuar në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale.

Pas shumë diskutimesh e mos pajtimesh, njëzëri u miratua që lista me familje për nevojë për dru zjarri ashtu siç është të dërgohet komplet në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale.

Mirsada Behluli, kryesuese tha se sa i përket situatës me dru zjarri jam e njoftuar dhe kam reaguuar, si dhe kam arritur kontakt me drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, ku ajo ka thënë se kjo ndihmë është e lejuar për 100 familje prej të cilave 30 janë për komunitetet jo shumicë.

Kam kontaktuar edhe me Zyrën për Komunitete me znj. Klaudia ku edhe ajo më ka konfirmuar të njëjtën çështje, por duke e lënë të hapur mundësinë që sigurimi i druve për zjarr të bëhet edhe përmes donacioneve.

Triera Kasumi - Berisha, tha se unë e konsideroj shumë alarmante çështjen që Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka buxhet aq të shkurtuar edhe besoj se nuk është hera e parë që kjo listë është me aq numër të madh.

Ajo në vazhdim tha se pa dyshim këtë çështje duhet ta ngritëm në Kuvend, po ashtu duhet ta ngritëm edhe tek Drejtoria e Financave të linjat buxhetore, si dhe duhet t'i përcjellim krejt hapat dhe mekanizmat që me mundur me bërë përkrahjen e këtyre familjeve për deri sa e dimë

se këto familje janë në gjendje shumë të vështirë, sepse ndarja e tyre do të ishte shumë primitive.

Po ashtu meqë i kemi 30 edhe i kemi 6 përfaqësues të komuniteteve jo shumicë, me shumë respekt nuk mundemi me i ndarë proporcionalisht në 5, për shkak se duhemi me shikuar nga ana financiare qysh qëndrojnë të gjithë pavarësisht se cilit komunitet i takojnë.

Besoj se duhemi me e pasur një ndarje varësisht prej kushteve se ka disa të cilët i kanë kushtet më të mira e disa i kanë vërtetë kushtet e rënda.

Betim Abdullahu, duke u ndërlidhur me diskutimin e znj, Kasumi- Berisha, tha se neve si zyrë nuk na takon me bërë klasifikim, pasi që për neve janë të barabartë secili. Por për ta vërtetuar këtë, është e vërtetë që edhe rastet që janë brenda kësaj liste dallojnë nga ana financiare.

Ne e dimë se kush i ka kushtet ekonomike apo cila pjesë është më e varfër, por ne as unë e as kolegët e mi nuk kishim dashur me hy e me bërë këtë ndarje, sepse nuk tingëllon mirë. Për këtë çështje un kam kontaktuar edhe kabinetin e kryetarit

Kështu që për mua më e lehta është që me u përkrahur të gjithë, pasi që unë e ndiej veten shumë keq pse ka ndodhur kjo, se ka kohë nuk kemi pasur këso telashe.

Ne viteve të kaluara i kemi shpërndarë drunjtë edhe fizikisht, ku unë kam tentuar me drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit me i shpërndarë se janë 400 metra dru te varrezat në Dragodan, që janë qe tri vite. Edhe në vitin e kaluar na kanë mbetur nja 10-15 familje pa u furnizuar me dru se nuk kanë mundur me u përkrah, por që ligjërisht drejtori nuk ka mundur me e gjetur një model se si të merren ato dru, pasi që ato janë të konfiskuara.

Por tash ju si asamble e keni një mundësi me e gjetur një model, listat i kemi të gatshme, drunjtë janë kurdo dhe ne kemi me e organizuar me Hortikulturën edhe me i shpërndarë nëpër lagje.

Elmira Nikçi - Rexha, lidhur me listën me emra të familjeve për ndihmë me dru zjarri tha se mendoj se lista duhet të dorëzohet komplet ashtu si kanë ardhur kërkesat, ndërsa e jona është vetëm me i gjetur modalitetet se si me e dorëzuar këtë listë.

Ajo në vazhdim tha se dje është takuar me kryetarin dhe drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit ku kanë diskutuar pikërisht për këtë çështje, si me e gjete një modalitet me i bërë këta drunjtë pronë të Komunës dhe Komuna me pasur të drejtë me e bërë shpërndarjen e tyre.

Lidhur me këtë çështje kemi mbetur me u konsultuar edhe me Zyrën ligjore, ku faktikisht ata e kanë marr si obligim me e konsultuar ligjin ku me gjet një variacion se si me e bërë këtë shpërndarje. Për këtë çështje sot e kemi një takim me drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, kryetarin dhe drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit, dhe besoj se gjatë ditës duhet të gjendet një zgjidhje, ku dhe më dt. 27.11.2022 e kemi mbledhjen e Kuvendit dhe aty bashkërisht do ta ngritëm zërin, se kjo ndarja vetëm për 30 familje nuk është e pranueshme as për mua e as për të tjerët.

Nenad Miladinovic, tha se sa i përket çështjes së druve zjarri ne me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, kemi bashkëpunuar shumë mirë gjithmonë kemi gjetur rrugëdalje edhe kur nuk ka pasur mjete në buxhet, meqë ka ndodhur ndonjëherë edhe kur i kemi korrigjuar listat por nuk kemi pasur problem, ndërsa për këtë që ju sot po e thoni vetëm 30 familje unë me të vërtetë nuk mundem ta pranoj.

Prandaj kisha me i lutur të gjitha komunitetet që së bashku ta marrim një qëndrim ose të sigurojmë dru për të gjithë, se kjo me të vërtetë nuk është e drejtë.

Ai mes tjerash propozoi që për takimin e ardhshëm të ftohet Kryetari i Komunës, qysh kishim me i paraqitur shqetësimet tona, se disa prej takimeve tona drejtorët të cilët ftohen në takim ata nuk i përgjigjen takimit.

Ndërsa sa i përket buxhetit tha se me sa e di buxheti duhet gjithsesi të prezantohet në Komitetin për Komunitete.

Mirsada Behluli, kryesuese tha se meqë i kemi dy asamblistë këtu në fund të takimit do ti japim rekomandimet ku një prej rekomandimeve do të jetë vërejtja për mos përgjigjen e drejtorëve të drejtorive në ftesat tona për takim.

Triera Kasumi - Berisha, tha se mua më vjen keq që nuk e kam ditur praktikën që më herët buxheti është diskutuar edhe në Komitetin për Komunitete, po ta kisha ditur ne e kishim bërë edhe një dëgjim publik, kishim bërë kërkesë edhe për një dëgjim publik përbrenda komuniteteve, përndryshe nëse ka ndonjë mekanizëm ligjor i cili neve na toleron që brenda buxhetit të krijojmë linja të reja, sepse vitin e ardhshëm patjetër do të bëhet ndryshimi i buxhetit.

Betim Abdullahu, tha se sa i përket buxhetit që është votuar për vitin 2023, nuk hynë në këtë skemën për këto ai është buxhet i vitit të kaluar.

Ne si zyre gjithmonë projektet tona i kemi të financuara prej drejtorive përkatëse si p.sh prej Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, prej linjës së kabinetit edhe prej Drejtorisë së Administratës.

Ai në vazhdim tha se nuk kishte qenë mirë që debatet që bëhen në këtë komitet të kthehen në ato politike as personale, dhe se nuk ka nevojë askush të del përtej kësaj se edhe herëve të tjera kemi pasur kësi probleme që rrugës i kemi zgjedhur deri në fund.

Ndërsa sa i përket listës me familje për dru zjarri krahasuar me vitet e kaluara i kemi përgatitur me kohë dhe do të tentojmë që të gjejmë një modalitet për ta kryer këtë punë.

Sa i përket buxhetit tha se ne e kemi një buxhet afër 100 mijë euro për linjën e infrastrukturës së komuniteteve, kurse këto të tjerat si p.sh dhuratat higjienike, ushqimore, shkollore janë të financuara nga drejtoritë përkatëse të Komunës së Prishtinës.

Elmira Nikçi - Rexha, tha se duke u nisur nga fakti se këtu nuk e përfaqësoj qeverinë por e përfaqësoj një pjesë të Kuvendit, si dhe nuk jam këtu për ti mbrojtur as të mirat e as të këqijat e asnjë drejtori në Komunën e Prishtinës, por jemi këtu për me i shty qasjet dhe kërkesat e juaja aq sa kemi mundësi.

Ndërsa sa i përket buxhetit apo linjës buxhetore, linjë buxhetore të veçantë për komunitete nuk ka pra jo vetëm për këtë komitet por për asnjë komitet në Komunën e Prishtinës.

Ajo në vazhdim tha se Zyra për Komunitete e ka subvencionimin 100 mijë euro, por kërkesat e tjera normal që realizohen përmes linjave të tjera të drejtorive përkatëse ku ka nevojë.

Nenad Miladinovic, tha se sa i përket buxhetit, është dashtë që dikush nga Drejtoria e Financave të vijë dhe ta prezantojnë buxhetin para miratimit siç është praktikuar më herët.

-Pas shumë diskutimesh e mos pajtimesh, njëzëri u miratua, që lista me familje që kanë nevojë për dru zjarri ashtu siç është të dërgohet komplet në Drejtorin e Mirëqenies Sociale.

Pika e shtatë

Raportimi i nga përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë për gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë u deklaruan se, sa i përket sigurisë në bashkësinë e tyre nuk kanë kurrfarë problemesh vetëm se ishin të shqetësuar lidhur me çështjen e ndarjes së druve për zjarr ku edhe shprehën pakënaqësitë dhe mos pajtimin e tyre.

Pika e tetë

Të ndryshme.

Në pikën të ndryshme u dhanë vërejtje nga anëtarët e Komitetit për Komunitete e ato janë:

- Mos përgjigjja e drejtorëve në ftesën e komitetit në takim,
- Pakënaqësia lidhur me çështjen e ndarjes së druve pasi që Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka lejuar ndihmën me dru zjarri vetëm për 30 familje,
- Mos prezantimi i buxhetit të Komunës për vitin 2023 në Komitetin për Komunitete.

Mes tjerash kryesuesja e komitetit tha se më 06.11.2022 sa për informatën e anëtarëve të Komitetit për Komunitete, është informuar nga u.d. udhëheqësi i ZKKK-së z. Betim Abdullahu ka mbajtur takim me Kryetarin e Komunës, ku kanë arritur marrëveshjen për lejimin e druve për të gjitha familjet që janë në listë, pra për 175 familje.

Pas shumë diskutimesh propozimesh dhe sugjerimesh, Komiteti për Komunitete nxjerri këtë

REKOMANDIM:

- *Për takimin e ardhshëm të ftohet Kryetari i Komunës, z. Përparim Rama,*
- *Të ftohet drejtorja e Drejtorisë së Arsimit, znj. Bresianë Musmurati.*

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit
Dr. Mirsada Behluli

Dr. Mirsada Behluli



Faqe6nga6